



REUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE ZHVILLIMIT

Datë: 02.10.2024

NJOFTIM PËR MOBILITET NË KUADËR TË ERASMUS + (STUDENTËT)

Në kuadër të marrëveshjes Erasmus + **KA 171 (2024/2025)**, midis **Universitetit Bujqësor të Tiranës** dhe **Universitetit Maribor, Slloveni** shpallet thirrja për aplikim për 1 mobilitet student për Studime dhe Trajnime të studentëve gjatë semestrit të dytë (2024-2025).

Ftohen studentët e në Universitetin Bujqësor të Tiranës të bëhen pjesë e këtij aplikimi. **Numri maksimal i kuotave në këtë thirrje është 1.**

Çdo student mund të shprehë interesin e tij përmes aplikimit duke plotësuar edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formulari i aplikimit me Marrëveshjen e Mësimin (Learning Agreement) – **ju lutemi vini re se është e detyrueshme të përdoren dokumentet që mund të gjenden ne linkun: <https://studentexchange.um.si/> (lloji i mobilitetit: CREDIT MOBILITY!).** Dokumenti duhet të konfirmohet nga studenti dhe koordinatori i Erasmus+ ose personi përgjegjës në departament ose fakultet dhe koordinatori institucional i Erasmus+ ose personi përgjegjës i institucionit dërgues.*

Cdo student i interesuar mund të informohet në lidhje me kurset përmes Katalogut të Kurseve në linkun: <https://www.erasmusplus.um.si/international-students/application/course-catalogue/>
2. Transkrip nga sekretaria mesimore për të gjitha provimet e kaluara për të gjitha nivelet e studimit me një notë mesatare.
3. Konfirmimi i njohjes së gjuhës angleze (të paktën niveli B1) në përputhje me CEFR (http://www.coe.int/t/dg4/linguistic/cadre1_en.asp). Njohja e gjuhës angleze duhet të dëshmohet me një konfirmim të verifikuar (**Shtojca 1**) nga një Pedagog i Lendes “Gjuhe Angleze” në universitet (UBT) ose me një rezultat TOEFL prej 42 (IBT) ose më shumë, IELTS 4.0 ose më shumë, ose me një certifikatë tjetër ekuivalente.
4. Një Deklaratë e nënshkruar për mobilitetin studentor të kryer më parë (**Shtojca 2**).
5. Një Deklaratë e nënshkruar për vendin e qëndrimit, lindjen dhe shtetësinë (**Shtojca 3**).
6. Një Letër Motivuese deri në 1 faqe A4 të nënshkruar nga aplikanti.
7. Curriculum Vitae (Europass) me përshkrimin e aktiviteteve shtesë (**Shtojca 4**).
8. Një Certifikatë të vlefshme të Regjistrimit (**nga sekretaria mesimore**).
9. Një kopje të një dokumenti personal të vlefshëm (**pasaportë ose ID**).



REUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE ZHVILLIMIT

10. Një kërkesë për krijimin e një numri unik personal – EMŠO: numri i identifikimit personal (**Shtojca 5**).
11. Një deklaratë GDPR për dhënien e pëlqimit për përdorimin e të dhënave personale (**Shtojca 6**).
12. Aplikim për financim shtesë për studentët me më pak mundësi (**Shtojca 8**).

*Studentët që aplikojnë për përgatitjen e diplomës, masterit ose tezës së doktoraturës gjithashtu duhet të bashkëngjisin “Planin e Aktivitetit të Mobilitetit” (**Shtojca 7**) të konfirmuar nga studenti dhe koordinatori i Erasmus+ ose një person tjetër përgjegjës në UBT.

Aplikimet duhet të dorëzohen elektronikisht në adresat:

- 1) erasmusoffice@ubt.edu.al
- 2) edelia@ubt.edu.al

Ju lutem në adresat e mësipërme mund të shkruani edhe për cdo paqartësi nga ana juaj në lidhje me aplikimin.

Afati i aplikimit fillon nga data e njoftimit të hapjes së thirrjes (02.10.2024) deri në datë 15 Tetor 2024.

Ju urojmë suksese!!!